



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHKODËR  
KËSHILLI BASHKIAK**

Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr.1 Shkodër,

web: [www.bashkiashkoder.gov.al](http://www.bashkiashkoder.gov.al),

e-mail: [keshilibashkiak@bashkiashkoder.gov.al](mailto:keshilibashkiak@bashkiashkoder.gov.al)

**V E N D I M**

**Nr. 1, datë 30.1.2017**

**Për plotësimin e vakancës në mandatin e anëtarit të këshillit bashkiak Shkodër**

Në mbështetje të nenit 49 pika 1, nenit 54 shkronja "j" të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", nenit 164 pika 2 e Kodit Zgjedhor, të ndryshuar, vendimit nr. 962, date 28.07.2015 të KQZ-së "Për shpërndarjen e mandateve për Këshillin e Bashkisë Shkodër, Qarku Shkodër për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 21.06.2015", shkresës nr. 120 prot, datë 19.1.2017 të KQZ-së, Relacionit të komisionit të mandateve të këshillit bashkiak, listës shumemërore "për kandidatët për këshillin bashkiak Shkodër për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 21.06.2015" të subjektit Partia Demokratike, Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e datës 30.1.2017, me propozim të komisionit të mandateve,

**V E N D O S I**

1. Miratimin e dhënies së mandatit të anëtarit të këshillit bashkiak Shkodër **znj. Antoneta Cin Çeklijaj**, si kandidate e radhës me numer rendor 24, në listën shumemërore të Partisë Demokratike, "për anëtarë të këshillit bashkiak Shkodër, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 21.06.2015".
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Sekretar i këshillit**

  
**Suel Hadri**

**KRYETAR**



  
**Xhemal BUSHATI**